

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndërpriten negociatat për presidentin mes LVV-së dhe LDK-së
ADRESA	https://albeu.com/kosove/nderpriten-negociatat-per-presidentin-mes-lvv-se-dhe-ldk-se/1012754/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:57:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:52:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cf97eaa8ac4729752dd7e369514b3028b3d85b8bccfac032321bcfc8cd7c675e
TEKSTI	aaaa760b04f187cab8381a2cfc01d8a867f63b0816656de7424cfce05d7d96a2
PAMJA	b6f47b68f5955a345496016ca6f6002af433a540ab456080373ba3bf231ff3e3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac2dbaab1cc13d0d45f676c09e81e0d98d4dbbc3dd49ccd6b6939eae11e2fc45
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac2dbaab1cc13d0d45f676c09e81e0d98d4dbbc3dd49ccd6b6939eae11e2fc45>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ndërpriten negociatat për presidentin mes LVV-së dhe LDK-së



Pas tërheqjes së Bekim Sejdiut nga gara për kreun e shtetit, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kanë vendosur të ndërpresin diskutimet për postin e presidentit. Të dyja partitë nuk parashikojnë takime në ditët në vijim.

Lidhja Demokratike, e cila zotëron 18 mandate në Parlamentin e Kosovës, nuk sheh arsye për t'u ulur në tryezë me partinë qeverisëse për këtë temë, përpara se Gjykata Kushtetuese të japë verdiktin e saj mbi ligjshmërinë e formimit të legjislaturës së 11-të.

Lutfi Haziri, nënkryetar i LDK-së, deklaroi prerazi për Radion Evropa e Lirë më 15 shtator se asnjë takim nuk do të zhvillohet pa vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Edhe burime brenda Lëvizjes Vetëvendosje konfirmuan pezullimin e negociatave, duke bërë të ditur se gjatë kësaj jave nuk është programuar asnjë takim me përfaqësues të LDK-së.

Një ditë më parë, më 14 shtator, Partia Demokratike e Kosovës, si forca më e madhe opozitare, e dërgoi në Gjykatën Kushtetuese procedurën e krijimit të Kuvendit, duke kërkuar gjithashtu edhe vendosjen e një mase të përkohshme.

Sipas ankesës së PDK-së, e dorëzuar të hënën, pushteti ka shkelur dispozitat kushtetuese që lidhen me mënyrën e zgjedhjes së drejtuesve të Kuvendit. Ata pretendojnë se nuk u respektuan afatet kohore të përcaktuara për themelimin e institucionit ligjvënës.

Konkretisht, sipas tyre, LVV dështoi të përmbushte afatin 30-ditor kushtetues për themelimin e Kuvendit, si dhe rregullin që kërkonte thirrjen e seancës çdo dy ditë deri në arritjen e këtij qëllimi.

Të martën, Gjykata Kushtetuese nuk dha asnjë përgjigje për Radion Evropa e Lirë lidhur me pyetjet nëse e ka

të fundit /



Qytetarët pranë moshës së pensionit mund të blejnë deri n...



BIK-u urdhëron ekspozimin e flamurit të UÇK-së në institucion...



Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliajn, reagon kryeministri...



Lehtësimi fiskal për karburantet/ Maqedonia e Veriut, Italia, Spanj...



Trump kundërshton rregullat shtesë për AI-n: Mos kini frikë nga...



Real Madridi mund të ndjekë modelin e Ronaldos për ta...



Sa ndikojnë protestat dhe kërcënimet në vendimin e gjykatës p...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

pranuar për shqyrtim kërkesën e PDK-së dhe nëse pritet ndonjë masë e përkohshme.

Marrëveshja e arritur më 31 gusht midis LVV-së dhe LDK-së për ta nominuar Bekim Sejdiun si kandidat për president dështoi më 14 shtator. Vetë Sejdiu njoftoi tërheqjen nga procesi për shkak të pamundësisë për të siguruar votat e nevojshme.

Gjashtë ligjvënës të LDK-së kundërshtuan mbështetjen për Sejdiun, i cili, siç bëri të ditur kryeministri Albin Kurti, gëzonte përkrahjen e vetëm 74 deputetëve. Rregullorja parlamentare kërkon praninë e minimumi 80 deputetëve në seancë për ta bërë të vlefshëm procesin e votimit.

Në njoftimin e tij në Facebook, Sejdiu shpjegoi se rrethanat e reja, të përcaktuara nga mungesa e mbështetjes parlamentare dhe devijimi i procesit në konflikte të brendshme politike, e shtynë të merrte vendimin për t'u larguar nga gara për kreun e shtetit.

Me daljen e Sejdiut, partitë politike duhet të negociojnë një marrëveshje të re për një kandidat tjetër. Nëse Parlamenti nuk arrin të zgjedhë presidentin, vendi do të përballet me zgjedhje të reja – të katërtat në harkun e dy viteve.

Sidoqoftë, analisti Dritëro Arifi është i mendimit se vazhdimi i bisedimeve midis LVV-së dhe LDK-së nuk është i përshtatshëm për momentin, pikërisht për shkak të kontestimit të legjitimitetit të Kuvendit që duhet ta zgjedhë presidentin.

Ai paralajmëroi për Radion Evropa e Lirë se në rast se procesi kthehet në pikën fillestare, të gjitha negociatat e deritanishme do të ishin të kota.

Megjithatë, nëse Gjykata Kushtetuese vërteton se themelimi i Kuvendit ishte në pajtim me ligjin, Arifi beson se arritja e një marrëveshjeje për president do të ishte e shpejtë, nëse palët tregojnë gatishmëri. Sipas tij, gjithçka mund të përmbyllet brenda një ore nëse vendimi është favorizues.

LVV dhe LDK, e cila ishte e vetmja parti që pranoi të dialogonte me fituesen e zgjedhjeve për këtë çështje, nuk kanë bërë të ditur emrat e tjerë që kanë qarkulluar gjatë negociatave përpara se të binin dakord për Sejdiun.

Sipas Arifit, në situatën e tanishme, kurdo që bisedimet të rifillojnë, alternativa më e përshtatshme do të ishte propozimi i një deputeti të LDK-së që gëzon mbështetje të gjerë, si brenda partisë ashtu edhe nga LVV, për të përfunduar së ndërtuari institucionet e reja të Kosovës.

Afati ligjor 60-ditor për zgjedhjen e presidentit filloi të llogaritet nga 13 shtatori, datë në të cilën Kuvendi shpalli themelimin e tij të përfunduar, ndërsa mandati i Albulena Haxhiut si presidente në detyrë përfundon më 4 tetor. / REL

Shtuar më 15.09.2026 15:52

Tags: [bisedimet](#), [ldk](#), [LVV](#), [pezullojne](#)



BIK-u urdhëron ekspozimin e flamurit të UÇK-së në institucionet dhe xhamitë ...



Sa ndikojnë protestat dhe kërcënimet në vendimin e gjykatës për ish-...



KDI i kërkon Gjykatës Kushtetuese masë të përkohshme për Kuvendi...



Kërkohet masë e përkohshme nga Kushtetuesja për...



Abdixhiku pret në takim shefin e ri të EULEX-it, në fokus sundimi i ligjit dhe...



Kriza për presidentin rikthehet në qendër: kompromisi mes Kurtit dh...



Momenti vendimtar afrohet, përfaqësues të PDK-së nisen për në Hagë



Oda e Mjekëve të Kosovës nderon kujtimin e Flora Brovinës: Mjekësia humb...



Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.